



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE

Nr. 239/1 Prot.

Tiranë, më 27.03.2015

VENDIM
“Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 24, datë 27/03/2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 239 Prot., datë 23.03.2015, ndaj Autoritetit Publik/Komuna Kashar, me objekt “Refuzim për dhënie informacioni”. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se, z. _____ në datë 26.02.2015 ka paraqitur pranë autoritetit publik/Komuna Kashar, kërkesën për lëshimin e vërtetimit të shitjes së pasurisë.

Ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën e tij për informim, pasi nuk ka marrë përgjigje për kërkesën. Për këtë arsye ka depozituar ankim në zyrën e Komisionerit. Pas shqyrtimit të ankesës, Komisioneri konstatoi se, ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 24/1/2/b të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, por informacioni i kërkuar konsiston në prodhimin e një informacioni të ri, ç’ka nuk është objekt i ligjit dhe është në kundërshtim me nenin 1 dhe 3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Ky informacion prodhohet nga Autoriteti Publik pas kërkesës me shkrim të kërkuarit, në kuadër të veprimtarisë dhe detyrave funksionale dhe institucionale të këtij autoriteti.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se ankesa rezulton e pa bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 237 Prot., datë 23.03.2015 të Z. _____, kundër Autoritetit Publik/Komuna Kashar.

Kundër këtij vendimi ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 27.03.2015.

